

Emri i Lëndës : E Drejta Publike							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
LAW 111	N/A	Vjeshtë	3.00	0.00	0.00	3.00	5.00
Lektori		Fioralba Markja, Msc					
Asistenti							
Gjuha e kursit		Shqip					
Niveli i lëndës		Bachelor					
Përshkrimi		Lënda do të fokusohet ne shpjegimin e parimeve kryesore dhe institucioneve te se drejtës publike, te tilla si shteti dhe e drejta, parimet e sovranitetit shtetëror, ndarjen e pushteteve, karakteristikat kryesore te shteteve dhe sistemet shtetërore. Në pjesën e parë, studentët njihen me rolin e teorisë së të drejtës në shkencat juridike në përgjithësi dhe në studimet juridike. Shpjegohen teoritë më të rëndësishme për origjinën e shtetit dhe të së drejtës dhe për shkencat juridike në përgjithësi. Më pas analizohet struktura e shtetit, organet dhe funksionet e tij. Në vijim diskutohen elementet e shtetit dhe trajtat e tij. Në pjesën e dytë paraqitet koncepti i normave juridike, ndarja e normave juridike bazuar në kriteret e ndryshme si dhe struktura e normave juridike. Analizohet koncepti i marrëdhënieve juridike dhe diskutohen elementet bazë të marrëdhënies juridike (subjektët e së drejtës, objekti i së drejtës, e drejta subjektive dhe detyrimi juridik). Shpjegohet koncepti i aktit juridik dhe diskutohen burimet e së drejtës (kushtetuta, ligji, aktet shtetërore nënligjore, aktet e personave publik dhe privat, e drejta zakonore, si dhe shkenca juridike). Pjesa e tretë paraqet studimin e konceptit të sistemit juridik dhe diskutohen njësitë themelore të sistemit juridik (norma juridike, institutet e së drejtës, degët e së drejtës, grupet e së drejtës). Më tutje, shqyrtohen teknikat themelore të interpretimit, mënyrat e zgjidhjes së çështjeve rreth zbrazëtirave juridike. Së fundi, shqyrtohen teori të ndryshme në lidhje me esencën dhe strukturën e së drejtës (teorisë së të drejtës natyrore, shkollën historike, teori e pastër e ligjit, etj).					
Objektivat		Kjo lëndë synon të pajisë studentët me parimet e funksionimit shtetëror; të japë një informacion ëe gjerë lidhur me institucionet kryesore te shtetit dhe funksionin e tyre. Karakteristikat e shteteve te ndryshme dhe mënyra e funksionimit te tyre. Qëllimet e studimit të kësaj lënde është që studenti të: identifikojë, kuptoje, emërtoj dhe të dalloj konceptet themelore të së drejtës; të kuptoje thelbin dhe formën, si dhe elementet bazë, organet dhe funksionet e shtetit; të identifikoj dhe përshkruaj institutet themelore, parimet, funksionet dhe vlerat e së drejtës; të dalloj dhe të identifikojë llojet kryesore të burimeve të së drejtës; të grupojë dhe të identifikojë elementet e sistemit juridik; të njihet me qasjet themelore teorike ndaj shtetit dhe të së drejtës; të emërtojë dhe të përshkruaj teknikat themelore të së drejtës.					
Konceptet Kryesore		1. E drejta 2. Kushtetuta 3. Norma Juridike 4. Parime 5. Institucionet Publike 6. Pushtetet 7. Institucionet e pavarura					
Programi i Lëndës							
Java		Tema					
1		Koncepti i së drejtës publike. Shoqëria, shteti dhe e drejta. Ky leksion i dedikohet zbrërthimit teorik të lëndës. Studentët njihen me rolin e teorisë së të drejtës në shkencat juridike në përgjithësi dhe në studimet juridike. (Kapitulli 1)					
2		Shteti; Koncepte te ndryshme per shtetin; Pushteti shteteror dhe sovraniteti. Shpjegohen teoritë më të rëndësishme për origjinën e shtetit dhe të së drejtës dhe për shkencat juridike në përgjithësi. Më pasa nalizohet struktura e shtetit, organet dhe funksionet e tij. (Kapitulli 2)					

3	Pushteti shtetëror dhe sovraniteti. Shpjegohen teoritë më të rëndësishme të pushtetit shtetëror dhe sovranitetit. Menyrat e ushtrimit të pushtetit. Kujt i perket sovraniteti. Po ashtu ushtrimi i sovranitetit përmes përfaqësuesve. (Kapitulli 3)
4	Forma e shtetit; Parimi i unitetit të pushtetit. Në vijim diskutohen elementet e shtetit dhe trajtat e tij. Njëkohësisht në leksion përshihen forma të ndryshme të shtetit duke i pasqyruar me shembuj konkret. Uniteti i pushtetit trajtohet specifikisht në një ore leksioni të veçantë. (Kapitulli 4)
5	Parimi i ndarjes së pushteteve. Analizimi i pushteteve me rradhe; Pushteti Legjislativ, Pushteti Ekzekutiv dhe Pushteti Gjyqësor. Ndarja dhe Balancimi i pushteteve dhe kontrolli i ndërsjellë i tyre. (Kapitulli 5)
6	Organizmi politik i shoqërisë dhe struktura e shtetit. Analizohet koncepti i marrëdhënieve juridike dhe diskutohen elementet bazë të marrëdhënies juridike: subjektët e së drejtës, objekti i së drejtës, e drejta subjektive dhe detyrimi juridik. Njëkohësisht, leksioni pason leksionin e mëparshëm duke u fokusuar në strukturat kryesore të shtetit. (Kapitulli 6)
7	E Drejta, kuptimi i së drejtës; norma juridike. Shpjegohet koncepti i aktit juridik dhe diskutohen burimet e së drejtës (kushtetuta, ligji, aktet shtetërore nënligjore, aktet e personave publik dhe privat, e drejta zakonore, si dhe shkenca juridike (Kapitulli 7)
8	Provimi Gjysmëfinal
9	Norma juridike; Koncepte të ndryshme për të drejtën. Nocioni i rendit juridik; Nocioni i normës juridike; Llojet e normave juridike; Vlefshmëria e normës juridike në territor (hapësirë); Vlefshmëria kohore e normave juridike; Fuqia prapavepruese (retroaktive) e normave juridike; Struktura e normës juridike (Kapitulli 8)
10	Shteti dhe e drejta në evolucionin e tyre historik. -shqyrtohen teoritë të ndryshme në lidhje me esencën dhe strukturën e së drejtës (teorisë së të drejtës natyrore, shkollën historike, teori të pastër të ligjit, etj (Kapitulli 9)
11	Koncepti i burimit të së drejtës. Trajtohen burimet e së drejtës, origjina e tyre, burimet akte dhe burimet fakte (Kapitulli 10)
12	Burimet kryesore të së drejtës. Trajtim i specifikuar në secilin prej burimeve kryesore të së drejtës, që nga ligji themelor i vendit, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara (e drejta ndërkombëtare), ligjet dhe zakoni (Kapitulli 11)
13	Marrëdhëniet juridike; Faktet juridike Elementet e marrëdhënies juridike; Subjektet e së drejtës (Personat fizikë dhe Personat juridik); Autorizimi juridik (E drejta subjektive, Keqpërdorimi i autorizimit, Keqpërdorimi i së drejtës subjektive, Kompetenca dhe Keqpërdorimi i kompetencës); Obligimi juridik (detyrimi) Gjendja juridike (statusi); Objekti i së drejtës Faktet juridike Parashkrimi (Kapitulli 12)
14	Zbatimi i së drejtës; Llojet dhe menyrat e interpretimit të ligjit Katër teoritë më të rëndësishme të së drejtës; E drejta natyrore; Pozitivizmi ligjor; Realizmi ligjor; Studimet kritike të së drejtës (Kapitulli 13)
15	Sistemi i së drejtës; Parimet e ndërtimit të sistemit të së drejtës. -paraqet studimin e konceptit të sistemit juridik dhe diskutohen njësitë themelore të sistemit juridik (norma juridike, institutet e së drejtës, degët e së drejtës, grupet e së drejtës) - shqyrtohen teknikat themelore të interpretimit, mënyrat e zgjidhjes së çështjeve rreth zbrazëtirave juridike; (Kapitulli 14)
16	Provimi Final

Parakushtet	Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.		
Literatura	• Luan Omari, Parime dhe Institucione te se Drejtës Publike (2013)		
Referenca të tjera	• Luan, Omari, • MacCormick, Neil. Institutions of law: an essay in legal theory. OUP Oxford, 2007. • Kelsen, Hans. General theory of law and state. Vol. 1. The Lawbook Exchange, Ltd., 1945. • Kelsen, Hans. Pure theory of law. Univ of California Press, 1967. Hart, Herbert Lionel Adolphus.		
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat			
1	Studentet do te jene ne gjendje te njohin burimet e shtetit dhe te se drejtës.		
2	Studentet do te njohin parimet kryesore te funksionimit te shtetit dhe institucioneve te tij.		
3	Studentet do te njohin format kryesore te organizmit shtetëror.		
4	Studentet do te njohin format kryesore te organizmit shtetëror.		
5	Studentët do te mund të kenë njohuri të gjera rreth anës historike, politike, sociologjike dhe filozofike të së Drejtës Publike në Shqipëri.		
Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme		Sasia	Përqindja
Gjysmë finale		1	35
Kuize		0	0
Projekte		0	0
Projekte semestrale		0	0
Punë laborator		0	0
Pjesëmarrja në mësim		1	15
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			50
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			50
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	3	48
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	5	70
Detyra	0	0	0
Gjysmë finale	1	0	0
Provimi final	1	0	0
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			118
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			4.72
ECTS			5.00